

Detajet e çështjes

Nr. i çështjes: 31004-03439-86-2015

Data e regjistrimit: 20-05-2015

Palët

Paditës: Edmond Braha

I paditur: Drejtoria e Pergjithshme e Sherbimeve te Transportit Rrugor Tirane, Drejtoria Rajonale e Sherbimeve te Transportit Rrugor Kukes

Objekti: Shfuqizimin teresisht te vendimit nr 285 date 23.12.2013 "per nderprerje te marredhenieve te punes" I nxjerre nga Drejtori I Pergjithshem I Sherbimeve te Transportit Rrugor dhe detyrimin e pales se paditur per te me rikthyer ne pune Detyrimin e te paditur

Relatori: Rilinda Selimi

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër, me vendimin Nr. 135, datë 24.02.2015 ka vendosur:

1. Pranimin e pjesshëm të kërkesëpadisë/ në këtë mënyrë :
2. Të konstatojë zgjidhjen e kontratës së punës së lidhur midis palës paditëse Edmond Braha e palës së paditur drejtoria rajonale e shërbimit të transportit rrugor Kukës, si zgjidhje me efekt të menjëhershëm e të pajustificuar.
3. Detyrimin e palës së paditur drejtoria rajonale e shërbimit të transportit rrugor Kukës për t'i dhënë palës paditëse Edmond Braha, pagë e shpërblim për dëmin, si më poshtë:
4. 1 - Pagën që do të kish fituar/ nëse marrëdhënia e punës do të përfundonte në fund të afatit të njoftimit, për afatin legjitim/ tre mujor\
5. 2 - Një dëmshpërblim prej 2 (dy) paga mujore për mosrespektim të procedurës së zgjidhjes së kontratës së punës;
7. 3 - Një dëmshpërblim prej 9 (nëntë) paga mujore/ për zgjidhjen e menjëhershme e të pajustificuar të kontratës së punës.
8. Rrëzimin e kërkesëpadisë në çështjen administrative nr.607/ 632 akti, datë 2.4.2014, që është ngritur nga pala paditëse Edmond Braha, për pjesët e tjera/ si e pabazuar në ligj e në prova.
9. Detyrimi për palën e paditur drejtoria rajonale e shërbimit të transportit rrugor Kukës, është i ekzekutueshëm nga përmbartuesi gjyqësor. Afati për ekzekutimin e vendimit fillon kur vendimi të marrë formë të prerë dhe mënyra e ekzekutimit të vendimit të bëhet në mënyrë të detyrueshme si për detyrimet në të holla

Gjykata Administrative e Apelit vendosi:

1. Ndryshimin e pjesshëm të vendimit Nr. 135 datë 24.02.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër. Detyrimin e palës së paditur t'i paguajë paditësit pagën e 1 (një) muaji e mbetur e papaguar në përfundim të afatit të njoftimit 3 mujor. Lënien në fuqi të vendimit për urdhërimet e tjera. Kundër vendimit lejohet rekurs në Gjykatën e Lartë brenda 30 ditëve nga e nesërmja e komunikimit të tij.

Data e

shpalljes:

12-07-2017